

Bashkia Vlorë

Adresa : Rruga Zigur Lelo, Vlorë, 9400 Tel. 033 231 000

<https://vlora.gov.al>

Ashtu si trajtojmë fëmijët sot, do të jetë e ardhmja nesër!

Plani i përmirësimit të shërbimit

Bashkia Vlorë ka miratuar në Këshillin Bashkiak, VKB nr. 97, datë 28.12.2020, "Plani i përmirësimit", plan i cili përcakton rregulla dhe standarde të funksionimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Vlorë dhe hapat për përmirësimin e shërbimit.

Regulloret

Bashkia Vlorë ka të hartuar dhe miratuar rregullore të funksionimit të arsimit parashkollor miratuar me nga Këshilli i Bashkisë me Vendim nr. 30, datë 12.06.2020 .

Secili prej institucioneve të arsimit parashkollor ka rregullore të brendshme të funksionimit. Regulloret janë hartuar dhe konsultuar me komunitetin, prindërit e fëmijëve, bordin dhe këshillat e prindërve, me qëllim gjithëpërfshirjen në vendimmarrje por edhe marrjen në konsideratë të mendimeve dhe rekomandimeve të tyre.

Këshillat e prindërve në kopshte

Këshillat e prindërve, bordi i institucionit dhe komisionet e disiplinës, shëndetësisë, sigurisë dhe etikës janë të ngritura dhe janë funksionale brenda çdo institucioni arsimor parashkollor. Çdo 3 muaj në institucionet e arsimit parashkollor thirret dhe mbledhet rregullisht këshilli i prindërve dhe bordi i institucionit me qëllim garantimin e transparencës dhe llogaridhënies për shërbimin e ofruar. Takimet shërbejnë gjithashtu për shkëmbim mendimesh dhe idesh që ndihmojnë në përmirësimin e punës. Këto mbledhje dokumentohen nëpërmjet procesverbaleve përkatëse të cilat bëhen publike.

Kopshte me orar të zgjatur

Bashkia Vlorë ofron edhe shërbimin e institucioneve parashkollore publike me ushqim dhe orar të zgjatur, një shërbim ky në ndihme të qytetarëve që punojnë me orar të zgjatur.

Shtresat në nevojë, Bashkia Vlorë i ka përjashtuar nga tarifa për regjistrimin e fëmijëve në kopsht.



Arsimi parashkollor

Nisma të ndërmarra

Me nismën e Sektorit të Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe mbështetjen e Bashkisë Vlorë u hartua dhe zbatua projekti që e bëri Bashkinë Vlorë te parën dhe të vetmen Bashki, e cila mundëson mjetet didaktike falas në institucionet arsimore parashkollore. Në vijim jemi duke punuar për të shtrirë këtë projekt për shpërndarje të mjeteve didaktike falas edhe në çerdhe.

Partneritete

Bashkia Vlorë dhe Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me donator BALFIN Group, kanë realizuar projektin "Përmirësimi i infrastrukturës dhe sistem me vende lojtrash në oborrin e jashtëm të Kopshtit Nr. 10, Vlorë".

Janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me palë të treta si Shkollat e Arsimit Profesional, DRFPP, DROSHKSH për të mundësuar marrjen e disa shërbimeve me kosto zero apo me kosto minimale për nxënësit dhe kusantet në këto institucione shtetërore.

Mësues ndihmës

Kemi shtuar ndjeshëm numrin e mësuesve ndihmës dhe do vazhdojmë ta bëjmë këtë vit pas viti me qëllim nxitjen e punës individuale me fëmijët me nevoja dhe aftësi të vecanta

Bashkëpunimi shkollë-kopësht

Institucionet e arsimit parashkollor dhe institucionet e arsimit parauniversitar bashkëpunojnë midis tyre duke organizuar vizita të grupeve të kopshteve në ambientet e shkollës. Edukatorët dhe mësueset e arsimit fillor bashkëpunojnë midis tyre duke ndarë përvoja, ide dhe risi në mësimdhënie në sesionet e tyre trajnuese dhe informuese. Vizitat i shërbejnë vecanërisht fëmijëve të grupit të 3-të, me qëllim njohjen e shkollës përpara nisjes së klasës së parë.

Pjesëmarrja komunitare

Pjesëmarrja e komunitetit në procesin e vendimmarrjes, por edhe gjatë ofrimit të shërbimit është prioriteti ynë.

Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sporteve pranë Bashkisë Vlorë në periudha të ndryshme kryen pyetësorë drejtuar qytetarëve (prindër) që përfitojnë shërbim arsimor prej institucioneve parashkollore publike nën varësinë e bashkisë, në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar. Rezultatet bëhen publike.

Ne monitorojmë shërbimin. Aspektet e monitorimit të shërbimit janë :

DREJTIMI / MENAXHIMI I KOPSHTIT

Kjo fushë përfshin

- Plani vjetor i kopshtit
- Plani i vëzhgimeve të procesit mësimor dhe edukativ
- Dokumentacioni i regjistrimit, statistikave dhe transferimet e fëmijëve
- Zhvillimi profesional i stafit
- Bashkëpunimi me specialistin social NJAP
- Menaxhimi i të ardhurave të kopshtit
- Dokumentacioni i inventarit të kopshtit

KUJDESI NDAJ FËMIJËS NË KOPSHT

Kjo fushë përfshin

- Siguria për jetën dhe shëndetin
- Cilësia e ushqimit dhe e higjienës
- Kujdesi për fëmijët që hyjnë për herë të parë në kopsht dhe që kalojnë nga kopshti në shkollë
- Kujdesi ndaj fëmijëve me prirje e nevoja të veçanta.
- Respektimi i individualitetit të çdo fëmije
- Mjedisi fizik i brendshëm i kopshtit
- Mjedisi fizik i jashtëm i kopshtit

ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE VETËVLERËSIMI

Kjo fushë përfshin :

- Efektiviteti i personelit
- Vlerësimi i mësueses
- Vetëvlerësimi i kopshtit

BASHKËPUNIMI DHE PARTNERITETI

Kjo fushë përfshin:

- Marrëdhënia e kopshtit me prindërit
- Marrëdhënia e kopshtit me komunitetin
- Marrëdhënia e kopshtit me NJAP-në
- Marrëdhëniet e kopshtit me të tretët



Mbulimi i territorit

Shërbimi arsimor për grupmoshën e fëmijëve parashkollor ofrohet në të gjitha Njësitë Administrative që Bashkia Vlorë ka në përbërje të saj.

Standarte dhe tregues

Në përputhje me Planin e përmirësimit të shërbimit, ne synojmë kalimin nga standartet aktuale në standarte më të larta të shërbimit.

Objektiva për të ardhmen

- Fuqizimi i Sektorit të Arsimit pranë Bashkisë Vlorë;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës së kopshteve;
- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet shtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i prindërve, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuar dhe në nevojë për përfshirje sociale.